



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV

Nr. 118/5 Prot.

Tiranë më 29.10.2020

URDHËR

Nr. 163, datë 29.10.2020

PËR KONTROLLUESIN "BANKERS PETROLEUM ALBANIA LTD"

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar (në vijim, "*Ligji*"), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*" (në vijim, "*Kodi i Procedurave Administrative*"), si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "*Bankers Petroleum Albania LTD*",

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 151, datë 30.09.2020 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "*Komisioneri*"), u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit "*Bankers Petroleum Albania LTD*" (në vijim, "*Kontrolluesi*"), me objekt:

- Verifikim i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga një shtetas, në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, konstaton se:

1. Kontrolluesi ka si objekt të veprimtarisë tregtare, kryerjen e operacioneve hidrokarbure në zonat e miratuara në marrëveshjet hidrokarbure. Ndërtimi dhe montimi i të gjitha mjeteve dhe paisjeve të kërkuara në operacionet hidrokarbure. Përdorimi, shitja, shkëmbimi, eksporti, nxjerrja dhe posedimi i naftës së prodhuar në zonat e miratuara në marrëveshjet hidrokarbure, etj.

Në kuadër të veprimtarisë që kryen, Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategoritë e subjekteve të të dhënave "*punëmarrës, punonjës të larguar, etj.*". Të dhënat përpunohen manualisht, si dhe nëpërmjet mjeteve elektronike.

Në kuadër të trajtimit të ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit, nr.1118 prot., datë 21.09.2020, të z. _____, nga provat e administruara gjatë hetimit administrativ, rezultoi se Kontrolluesi ka përpunuar (përhapur) të dhënat personale të ankuesit dhe të familjarëve të tij, drejt mediave.

Më tej, gjatë hetimit administrativ, u konstatuan 10 komunikime elektronike (nëpërmjet e-mailit zyrtar) midis punonjësve të Kontrolluesit (dy e-maile dërguar drejt mediave), në lidhje me publikimin e “*Njoftimit për Shtyp*”, pranë mediave të ndryshme, me objekt veprimtarinë e ankuesit gjatë ushtrimit të detyrës së tij si Drejtor i Përgjithshëm i Kontrolluesit.

Komunikimet e brendshme lidhur me konceptimin, aprovimin dhe dërgimin e “*Njoftimit për Shtyp*” për publikimin në media, datojnë nga 14.07.2020 dhe në vijim.

Gjithashtu, rezultoi se, më datë 05.10.2020, Kontrolluesi i është drejtuar me një letër të hapur 11 subjekteve (institucione vendase, parti politike dhe ambasada të huaja), lidhur me veprimtarinë e ankuesit gjatë ushtrimit të detyrës pranë Kontrolluesit, nga përmbajtja e së cilës rezulton të jenë përhapur/transferuar, drejt subjekteve në fjalë, të dhëna personale të ankuesit dhe jo vetëm.

Konstatohet, gjithashtu, që transferimi i të dhënave të ankuesit, në kuadër të letrës të Kontrolluesit, drejt subjekteve marrëse të caktuara, përbën edhe transferim ndërkombëtar të dhënash personale, përpunim i cili duhet të kryhet në përputhje me dispozitat e neneve 8 dhe 9 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se publikimi, përhapja dhe transferimi i të dhënave personale të ankuesit, nga ana e Kontrolluesit, drejt mediave/portaleve, si dhe kontrolluesve të tjerë (të cilët, ndër të tjera, nuk kanë për kompetencë të kryejnë hetime penale dhe/ose administrative, për veprimtari të paligjshme, të pretenduara, në ngarkim të ankuesit, apo nuk legjitimohen të përpunojnë të dhënat personale të ankuesit për çfarëdolloj qëllimi tjetër), është në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale parashikuar në nenin 5, me kriteret ligjore të përpunimit parashikuar në nenin 6, si dhe me rregullat për transferimin ndërkombëtar të të dhënave, parashikuar në nenet 8 dhe 9 të Ligjit.

Publikimi, përhapja dhe transferimi i të dhënave personale konsiderohet përpunim në bazë të pikës 12 të nenit 3 të Ligjit dhe, si i tillë, ky përpunim legjitimohet vetëm nëse plotësohet, të paktën, një nga kriteret e sanksionuara në nenin 6 të Ligjit.

Nga veprimet hetimore të grupit të inspektimit nuk rezultoi e provuar që Kontrolluesi, në kuadër të përhapjes/publikimit/transferimit të dhënave personale të ankuesit drejt medias dhe subjekteve marrëse (të cilat nuk rezultojnë të legjitimohen për të realizuar një

përpunim të tillë), të ketë përmbushur ndonjë nga kriteret ligjore të përpunimit (përhapjes/publikimit/transferimit) të të dhënave personale të ankuesit.

Në këtë rast, Zyra e Komisionerit vlerëson se përpunimi i mësipërm (përhapja/publikimi/transferimi) i të dhënave të ankuesit, drejt kontrolluesve të tjerë, nuk gjen mbështetje në asnjë parashikim ligjor konkret me qëllim që të konsiderohet i ligjshëm.

Zyra e Komisionerit vlerëson se Kontrolluesi ka detyrimin që të përpunojë ato të dhëna që janë të nevojshme për të arritur qëllimin ligjor përkatës të përpunimit, duke respektuar parimin e ligjshmërisë së përpunimit dhe mjaftueshmërisë së të dhënave personale, sanksionuar, respektivisht, në germat "a" dhe "c" të pikës 1 të nenit 5 të Ligjit.

Ky detyrim është veçanërisht i rëndësishëm sa i përket përpunimit të të dhënave të ankuesit, të cilat nuk lidhen me veprimtarinë dhe funksionet e tij gjatë kohës së ushtrimit të detyrës si Drejtor i Përgjithshëm i Kontrolluesit, të tilla si, por pa u kufizuar, komunikimet dhe korrespondencat (shkresore dhe/ose elektronike) me natyrë private, pavarësisht se për këtë qëllim mund të jenë përdorur, ndër të tjera, llogaritë e e-mail të vëna në dispozicion të ankuesit nga ana e Kontrolluesit.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 8, 29, 30 pika 1, germa "b" dhe 32 të Ligjit,

URDHËROJ:

1. Kontrolluesi, në kuadër të respektimit të parimit të ligjshmërisë dhe mjaftueshmërisë së të dhënave personale, parashikuar në germat "a" dhe "c" të pikës 1 të nenit 5 të Ligjit, të realizojë në mënyrë të menjëhershme ndërprerjen e përpunimit (përhapjes/publikimit/transmetimit) të të dhënave personale të ankuesit tek palë të treta që nuk legjitimohen për një përpunim të tillë, si dhe të ndalojë përpunimin e të dhënave personale të ankuesit, për të cilat vetë Kontrolluesi nuk legjitimohet t'i përpunojë dhe/ose të cilat nuk janë të nevojshme për të arritur qëllimin e ligjshëm të përpunimit;
2. Kontrolluesi të fshijë/shkatërrojë të dhënat e grumbulluara në tejkalim të qëllimit të përpunimit, siç tregohet në pikën 1 më sipër, të cilat janë përpunuar në kundërshtim me dispozitat e nenit 5 të Ligjit;
3. Kontrolluesi të marrë masa organizative dhe teknike të përshtatshme lidhur me përpunimin e të dhënave personale në përputhje me dispozitat e parashikuara në nenet 5, 6, 8 dhe 9 të Ligjit, si dhe për adresimin e konstatimeve të Komisionerit në lidhje me shkelje të këtyre dispozitave;
4. Kontrolluesi të përmbushë detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
 - (i) menjëherë, detyrimet e parashikuara në pikën 1 dhe 2; dhe

(ii) në vazhdimësi, detyrimin e parashikuar në pikën 3.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;

5. Kontrolluesi të njoftojë Zyrën e Komisionerit për masat e marra.
6. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas pikës 2 të nenit 30 dhe nenit 39 të Ligjit. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të Urdhrave të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative.

Ky urdhër u shpall sot më, 29 .10.2020

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

